

---

**AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI I  
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
“UNIQUE STUDIO” SH.P.K.**

---

**AKTI I THEMELIT DHE STATUTI**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“UNIQUE STUDIO” SH.P.K.**

**KREU I**

**EMRI I SHOQËRISË, SELIA, KOHËZGJATJA, OBJEKTI**

**NENI 1**

**EMRI I SHOQËRISË**

- 1.1 Shoqëria themelohet si përgjegjësi te kufizuar dhe do te mbaje emrin tregtar “UNIQUE STUDIO” Sh.P.K” (më poshtë e quajtur “Shoqëria”).

**NENI 2**

**SELIA**

- 2.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën **Rruga “Brigada e Tete”, Pallatet Agimi, (Nr. 358/1, Nr. 358/2, Nr. 2 dhe Nr. 5), Njësia Bashkiake nr. 5, Tiranë, Shqipëri.**
- 2.1 Ortaku i vetëm ose sipas rastit Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve te Shoqërisë mund të vendosë mbi transferimin e selisë së Shoqërisë në një adresë tjetër. Organi administrues i Shoqërisë mund të themelojë ose mbyllë degë dhe/ose zyra përfaqësimi, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë.

**NENI 3**

**KOHËZGJATJA**

- 3.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhe kohore të pacaktuar.

**NENI 4**

**OBJEKTI I VEPRIMTARISË**

- 4.1 Shoqëria ka për objekt të veprimtarisë së saj kryerjen e të gjitha aktiviteteve që një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar mund të ushtrojë në bazë të legjislacionit shqiptar, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, duke përfshirë por pa u kufizuar në:
- Ofrimin e shërbimeve te specializuara ne fushën e parukerise, estetikes dhe dermatologjisë.
- 4.2 Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër të lidhur ose të nevojshëm, me qëllim përmbushjen e objektit të saj të aktivitetit, në Shqipëri ose jashtë saj. Në drejtim të përmbushjes së objektit të saj, Shoqëria mund të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme ose të dobishme, ose që kanë të bëjnë me, përfshirë por pa u kufizuar në:
- import- eksportin, shitjen dhe blerjen si dhe transportin e mallrave e produkteve të lidhura me objektin e veprimtarisë se saj tregtare;
  - ofrimin e garancive reale dhe/ose personale për detyrimet e veta dhe të të tretëve, veprime me pasuri të luajtshme, të paluajtshme, tregti dhe çdo veprim tjetër të lidhur me objektin e veprimtarisë se saj tregtare;
  - pjesëmarrje në shoqëri shqiptare apo të huaja, si dhe lidhjen e marrëdhënieve kontraktore apo te bashkëpunimit me palë të treta publike ose private, vendase ose te huaja që kryejnë aktivitete të njëjta apo të ngjashme.

M.Xh

## **KREU II**

### **KAPITALI I SHOQËRISË, KALIMI I KUOTAVE, ZMADHIMI DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT**

#### **NENI 5**

#### **KAPITALI I SHOQËRISË**

5.1 Kapitali i Shoqërisë është prej **100 Leke (një qind leke)**, që konsiston në **1 (një) kuotë** që përfaqëson 100% të kapitalit themeltar të Shoqërisë dhe është nënshkruar rregullisht dhe e paguar nga **Ortaku i vetem**:

- **Znj. Meri Xhepa**, shtetase shqiptare, lindur më 11.11.1979, në Salari, Tepelenë, me banim në Tiranë, mbajtëse e pasaportës shqiptare nr. BC1972770, dhe numër personal H96111012R, zotëruese e 1 (një) kuotë pjesëmarrje, me vlerë nominale 100 (një qind) Lekë, që përfaqëson 100% të kapitalit themeltar të Shoqërisë;

5.1 Ortaket, mund të transferojnë kuotat e tyre përkatëse të pjesëmarrjes në Shoqëri vetëm nëpërmjet procedurës së mëposhtme. Në rast se një nga ortakët dëshiron të cedojë, plotësisht apo pjesërisht, kuotën e tij, ai/ajo duhet t'ia ofrojë së pari kuotën e tij për blerje ortakëve tjerë të Shoqërisë (E drejta e parablerjes). Ortakët kanë të drejtë të blejnë kuotën e ofruar për shitje në përputhje me çmimin dhe sipas kushteve të rëna dakord ndërmjet ortakut shitës dhe blerësit potencial, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga njoftimi i ortakut që shet, i cili do të përmbajë së paku qëllimin e ortakut për të shitur kuotën, përqindjen e saktë të shitjes dhe çmimin e kësaj shitje. Në rast se ortakët e tjerë japin përgjigje pohuese, ortaku që shet do t'i transferojë atyre kuotën e tij pro rata brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja e njoftimit të tyre mbi ushtrimin e Të Drejtës së Parablerjes. Në rast se ortakët e tjerë nuk japin përgjigje pohuese, ose përfundon afati i mësipërm 30-ditor, ortaku shitës do të ketë të drejtë të shesë lirisht kuotën e tij/saj.

5.3 Pavarësisht nga parashikimet e paragrafit 5.2, secili ortak mund të shesë lirisht, plotësisht ose pjesërisht, kuotën e tij një shoqërie të kontrolluar nga ky ortak.

5.4 Në rast zmadhimi apo zvogëlimi të kapitalit themeltar të Shoqërisë, ortakët do të kenë të drejtën e nënshkrimit të zmadhimit apo zvogëlimit të kapitalit në përpjesëtim të drejtë me pjesëmarrjen që zotëron secili prej tyre në kapitalin e Shoqërisë.

#### **NENI 6**

#### **KALIMI I KUOTAVE ME TRASHËGIMI OSE SI PASOJË E FALIMENTIMIT TË ORTAKUT**

6.1 Nëse një ortak vdes, trashëgimtari ose trashëgimtarët në rastin e bashkëzotërimit të kuotave, dhe trashëgimtarët e tij në rast se ky person ishte zotërues ose trashëgimtar i vetëm i bashkëzotëruesve të kuotave, do të jenë personat e vetëm të njohur nga Shoqëria që gëzojnë të drejta mbi kuotën e tij; pavarësisht parashikimeve të këtij Statuti, pasuria e ortakut të vdekur nuk çlirohet nga çdo përgjegjësi në lidhje me çdo kuotë të zotëruar vetëm nga ai apo së bashku me persona të tjerë.

6.2 Personi që fiton të drejtën mbi një kuotë si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një ortakut mund të zgjedhë ose të bëhet zotërues i kuotës, ose të kërkojë regjistrimin e personi tjetër të caktuar prej tij si përfitues të kuotës. Nëse personi i mësipërm zgjedh të bëhet zotërues i kuotës, ai njofton Shoqërinë në lidhje me këtë zgjedhje. Nëse ky person zgjedh që një person tjetër të regjistrohet si zotërues i kuotës, ai e kalon kuotën në dobi të personit tjetër nëpërmjet nënshkrimit të një instrumenti për transferimin e kuotës.

M. Xh

- 6.3 Personi që fiton të drejtat mbi një kuotë si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një ortaku do të ketë të drejtat që gëzonte zotëruesi i kuotës, duke përjashtuar të drejtën e pjesëmarrjes ose të votës në çdo mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, deri në momentin e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) si zotërues i kuotës.

#### **NENI 7**

##### **ZMADHIMI I KAPITALIT**

- 7.1 Kapitali mund të rritet në çdo kohë me vendim të Ortakut të Vetëm/Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, të marrë me shumicën e cilësuar të parashikuar në këtë Statut, sic përcaktohet tek neni 9, më poshtë. Vendimi i Asamblesë së Përgjithshme për zmadhimin e kapitalit do t'i komunikohet me njoftim me shkrim ortakëve të cilët megjithëse janë thirrur rregullisht nuk kanë marrë pjesë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme që merr vendim mbi këtë çështje.
- 7.2 Në rast zmadhimi të kapitalit, të gjithë ortakët do të kenë të drejtë të nënshkruajnë zmadhimin në para fizike të kapitalit, në përpjesëtim të drejtë me kuotën që zotërojnë në Shoqëri, në përputhje me vendimmarrjen e Asamblesë së Përgjithshme. Kontributet në natyrë janë të lejueshme me kusht miratimit nga Asambleja e Përgjithshme, vendim i cili do të kërkojë miratim me shumicë të cilësuar në Mbledhjen e Asamblese. Kontributet në natyrë do të vlerësohen me marrëveshje të përbashkët me shkrim ndërmjet ortakëve. Në rast se ortakët nuk bien dakord mbi vlerën e kontributit në natyrë, secili prej tyre mund t'i drejtohet gjykatës kompetente për emërimin e një eksperti.
- 7.3 Nëse ortakët heqin dorë nga e drejta për të nënshkruar zmadhimin përkatës të kapitalit apo nuk e ushtrojnë këtë të drejtë brenda afateve dhe në mënyrën e përcaktuar në vendimin e Asamblesë së Përgjithshme, zmadhimi i kapitalit mund të nënshkruhet nga ortakët e tjerë ose nga palët e treta të interesuara, duke u ruajtur ushtrimi i të drejtës së parablerjes nga ortakët. Në këtë rast këta ortakë kanë të drejtë të ushtrojnë përsëri të drejtën për të nënshkruar zmadhimin përkatës të kapitalit, përpjesëtimisht me kuotën e tyre përkatëse.

#### **NENI 8**

##### **ZVOGELIMI I KAPITALIT**

- 8.1 Shoqëria mund të zvogëlojë kapitalin me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të marrë me shumicën e cilësuar të parashikuar në këtë Statut. Në çdo rast, kapitali i Shoqërisë nuk mund të zvogëlohet nën kufirin e parashikuar me ligj.
- 8.2 Zvogëlimi i kapitalit përballohet nga secili ortak në përpjesëtim të drejtë me kuotën e zotëruar në Shoqëri.

#### **KREU III**

##### **ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME**

#### **NENI 9**

##### **ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME**

- 9.1 Organi vendimmarrës i shoqërisë është Asambleja e Përgjithshme. Asambleja e Përgjithshme vendos mbi të gjitha çështjet në kompetencë të saj sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi, këtij Statuti dhe/ose çdo marrëveshjeje të veçantë të ortakëve. Asambleja e Përgjithshme vendos mbi çështjet e mëposhtme:
- a) ndryshimet e Statutit;

M. Xu

- b) emërimin dhe shkarkimin e Administratorëve;
  - c) emërimin dhe shkarkimin e eksperteve kontabël të pavarur dhe të likuiduesve;
  - d) përcaktimin e shpërblimit për personat e përmendur në shkronjat b) dhe c);
  - e) monitorimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga Administratorët, duke përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raportit të ecurisë së veprimtarisë;
  - f) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - g) Shpërndarjen e fitimeve vjetore;
  - h) Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
  - i) Pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
  - j) Riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë;
  - k) Përcaktimi dhe ndryshimi i politikave të biznesit të Shoqërisë
  - l) Çështje të tjera të parashikuara nga ligji.
- 9.2 Secili ortak ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme, të paraqesë mendimet e tij dhe të ushtrojë të drejtën e votës në përputhje me kuotat që zotëron në kapitalin e Shoqërisë.
- 9.3 Secili ortak ka të drejtë të caktojë nëpërmjet një prokure me shkrim një përfaqësues, i cili mund të jetë një ortak tjetër apo një person i tretë, në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme.
- 9.4 Ortaku nuk mund të delegojë të drejtën për të votuar për një pjesë të kuotave të tij të kapitalit, nëse voton personalisht për pjesën e mbetur të tyre.
- 9.5 Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme mund të mbahet brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Ortakët ose përfaqësuesit e autorizuar mund të marrin pjesë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme nëpërmjet mjeteve elektronike, përfshirë telekonferencën (*conference call*) audio ose video, në përputhje me ligjin për tregtarët dhe shoqëritë tregtare dhe ligjin për komunikimet elektronike. Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme do të quhet e mbajtur në vendin ku ndodhet Kryetari i saj dhe Sekretari i mbledhjes, me qëllim që të hartohet dhe të nënshkruhet procesverbali në librin përkatës.
- 9.6 Asambleja e Përgjithshme mund të thirret nga Administratori/ët ose nga ortakët që përfaqësojnë të paktën 5% të kapitalit të Shoqërisë. Thirrja e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme duhet të bëhet nëpërmjet njoftimit me shkrim ose me mjete elektronike, dërguar secilit prej ortakëve në adresat e njoftuara Shoqërisë, të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) ditë përpara datës së caktuar për mbledhjen e saj. Njoftimi duhet të përmbajë rendin e ditës, vendin, datën dhe orën e mbledhjes.
- 9.7 Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme kryesohen nga Administratori/ët. Asambleja e Përgjithshme cakton një sekretar për çdo mbledhje midis personave të pranishëm.
- 9.8 Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të jenë me shkrim dhe të firmosen nga kryetari dhe sekretari. Me kërkesë të ortakëve, vendimet duhet të përfshijnë dhe deklaratat apo vërejtjet e tyre.
- 9.9 Asambleja e Përgjithshme mblidhet të paktën një herë në vit, brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar.
- 9.10 Asambleja e Përgjithshme, në rastin e vendimeve që kërkojnë shumicën e zakonshme, merr vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote ose përfaqësuesit e tyre, që zotërojnë më shumë se 30% (tridhjetë për qind) të kapitalit të

Shoqërisë, përveç rasteve të parashikuara më poshtë në nenin 9.12. Në rast se ky kuorum nuk arrihet, Asambleja e Përgjithshme thirret në një mbledhje të dytë brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga mbledhja e parë.

- 9.11 Asambleja e Përgjithshme do të konsiderohet e thirrur në mënyrë të vlefshme, pavarësisht këtyre formaliteteve, nëse të gjithë ortakët ose përfaqësuesit e tyre janë të pranishëm dhe e miratojnë rendin e ditës së mbledhjes.
- 9.12 Asambleja e Përgjithshme vendos me votat pro të  $\frac{3}{4}$  të ortakëve pjesëmarrës që zotërojnë më shumë se 50% të kapitalit të Shoqërisë për ndryshimin e këtij Akt Themelimi dhe Statuti, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë.

#### KREU IV

### ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

#### NENI 10

#### ADMINISTRIMI

- 10.1 Shoqëria do të administrohet nga një Administrator, i zgjedhur nga Asambleja e Përgjithshme për një periudhë prej 5 (pesë) vjetësh. Administratori mund të rizgjidhet në detyrë ose shkarkohet nga Asambleja e Përgjithshme. Asambleja e Përgjithshme përcakton shpërblimin e Administratorit.
- 10.2 Administratori gëzon të drejta të plota në lidhje me administrimin e Shoqërisë dhe mund të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të nevojshme për përmbushjen e objektit të Shoqërisë, me përjashtim të kompetencave të cilat ligji dhe ky Statut ja rezervon Asamblesë së Përgjithshme apo organeve të tjera të Shoqërisë (nëse ka). Administratori përfaqëson Shoqërinë në marrëdhëniet me palë të treta, publike ose private, autoritetet vendase apo të huaja, institucionet bankare, autoritetet tatimore dhe ato gjyqësore.
- 10.3 Administratori mund të delegojë tek persona të tretë kompetenca specifike lidhur me administrimin e Shoqërisë, deri në kufi të kompetencave që i akordohen atij me këtë Statut, në drejtim të mbarëvajtjes normale të biznesit të Shoqërisë.
- 10.4 Në çdo rast, Administratori do të jetë përgjegjës në mënyrë të drejtpërdrejtë për të gjitha veprimet e kryera nga përfaqësuesit në lidhje me administrimin e Shoqërisë.
- 10.5 Administratori do të veprojë në çdo kohë vetëm në interesin më të mirë të Shoqërisë. Në rastin e një konflikti interesi, Administratori njofton menjëherë ortakët dhe nuk do të kryejë asnjë veprim lidhur me objektin e konfliktit të interesit, deri në marrjen e udhëzimeve përkatëse nga Asambleja e Përgjithshme.
- 10.6 **Administratori i Shoqërisë është:**  
**Znj. Meri Xhepa**, shtetase shqiptare, lindur më 11.11.1979, në Salari, Tepelenë, me banim në Tiranë, mbajtëse e pasaportës shqiptare nr. BC1972770, dhe numër personal H96111012R. Administratorja emërohet në detyrë për një periudhë 5 vjecare.

#### NENI 11

#### PERFUNDIMI I DETYRES DHE SHKARKIMI I ADMINISTRATORIT/VE

- 11.1 Detyra e Administratorit përfundon në rast se:
- (a) personi nuk gëzon cilësinë e Administratorit sipas parashikimeve të ligjit;
  - (b) personi ndodhet në gjendje paaftësie paguese;

M. Xu

- (c) personi vuan ose mund të vuajë nga çrregullime mendore;
- (d) personi jep dorëheqjen nga detyra duke njoftuar Shoqërinë, ose
- (e) ka munguar pa arsye në detyrë për më shumë se 6 (gjashtë) muaj radhazi dhe Asambleja e Përgjithshme vendos ta shkarkojë nga detyra.

## KREU V

### **KONTROLI FINANCIAR I SHOQËRISË, VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, DIVIDENDI**

#### **NENI 12**

##### **KONTROLI FINANCIAR**

- 12.1 Kontrolli financiar i Shoqërisë do të kryhet nga Ekspertë Kontabël të Autorizuar, sipas legjislacionit shqiptar në fuqi. Asambleja e Përgjithshme do të emëroje një apo më shumë Ekspertë Kontabël të Autorizuar në ato raste kur emërimi i tyre konsiderohet i nevojshëm ose kërkohet në bazë të ligjit.

#### **NENI 13**

##### **VITI FINANCIAR**

- 13.1 Viti Financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor, të çdo viti.

#### **NENI 14**

##### **BILANCI VJETOR**

- 14.1 Bilanci vjetor, pasqyrat financiare, inventari, raportet e Administratorëve dhe të Ekspertit Kontabël të Autorizuar (nëse janë emëruar) miratohen nga Asambleja e Përgjithshme. Këshilli i Administrimit i paraqet për miratim Asamblesë së Përgjithshme raportin mbi administrimin e Shoqërisë si edhe llogaritë vjetore.
- 14.2 Dokumentet që kanë të bëjnë me vitin financiar miratohen nga Asambleja e Përgjithshme brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar.

#### **NENI 15**

##### **DIVIDENDI**

- 15.1 Në përputhje me ligjin për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare, Shoqëria, me shumicë të kualifikuar të votave së Asamblesë të Përgjithshme siç përcaktohet tek neni 9.10 me lart, mund të deklarojë shpërndarjen e dividendëve në përputhje me të pjesëmarrjen në kapital të ortakëve.
- 15.2 Përveçse nëse parashikohet ndryshe nga të drejtat e lidhura me kuotat, të gjithë dividendët do të deklarohen dhe shpërndahen në përputhje me shumatat e paguara për kuotat mbi të cilat shpërndahet dividendi.
- 15.3 Asnjë dividend ose shpërblim tjetër i pagueshëm në lidhje me një kuotë nuk do të mbartë interes në dëm të Shoqërisë, përveçse nëse parashikohet ndryshe nga të drejtat e lidhura me kuotën.

## KREU VI

### **PRISHJA DHE LIKUIDIMI, LIGJI I ZBATUESHËM ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE**

#### **NENI 16**

##### **PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË**

- 16.1 Në rastin e prishjes dhe likuidimit të Shoqërisë do të zbatohen dispozitat e parashikuara në ligjin për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare.

**NENI 17**

**LIGJI I ZBATUESHËM**

- 17.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë Akt Themelimi e Statut dhe ligjin shqiptar. Për sa nuk është parashikuar në këtë akt, do të zbatohen dispozitat e legjislacionit shqiptar në fushën e shoqërive tregtare.

**NENI 18**

**ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE**

- 18.1 Mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet Shoqërisë dhe ortakëve, apo ndërmjet ortakëve dhe trashëgimtarëve të ortakëve ose ortakëve të tjerë dhe/ose Shoqërisë, në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e këtij Akti Themelimi e Statuti, do të zgjidhen miqësisht e drejtpërdrejt ndërmjet palëve të interesuara. Në rast se palët nuk arrijnë një zgjidhje miqësore, kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane.

**NENI 19**

**GJUHA**

- 19.1 Ky Akt Themelimi dhe Statut nënshkruhet në 3 (tre) ekzemplarë të njëjtë në gjuhën shqipe me vlerë të njëjtë secila.

Nënshkruar më datë 20.09.2018

**ORTAKU**

**Meri XHEPA**

Meri Xhepa M. Xj